



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KUVENDI

Komisioni Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore

PROCESVERBAL

Tiranë, më 07.05.2019, ora 17:00

Drejtojnë mbledhjen:

Damian Gjikhuri – bashkëkryetar dhe Rudina Hajdari – bashkëkryetare

Rendi i ditës:

Miratimi i axhendës së punës së komisionit në vazhdim

Miratimi i ekspertëve pranë Komisionit

Miratimi i kërkesës për mbështetje për ekspertizë nga OSBE-ja për sistemin zgjedhor

Marrin pjesë:

Damian Gjikhuri, Rudina Hajdari, Vasilika Hysi, Klotilda Bushka, Blerina Gjylameti, Alket Hyseni, Bashkim Fino, Arben Elezi, Myslim Murrizi, Korab Lita, Nimet Musaj dhe Ralf Gjoni.

Mungojnë:

Të ftuar:

Susanne Schütz – Ambasadore e Republikës Federale të Gjermanisë në Shqipëri

Bernd Borchardt – Ambasador i OSBE-së në Shqipëri

Guusje Korthals Altes – Ambasadore e Hollandës në Shqipëri

Leyla Moses-Ones – E Ngarkuar me Punë e ambasadës së SHBA-së në Shqipëri

Jutta Gützkow – Shefe e zyrës së Këshillit të Europës në Shqipëri

Nicoletta Piccirillo – Zëvendësambasadore e Italisë në Shqipëri

Isabelle Le Guellec – Zëvendësambasadore, Konsulle e Parë, e Francës në Shqipëri

Sean Melbourne – Zëvendësambasador i Mbretërisë së Bashkuar në Shqipëri

Ian Crawford – Oficer për Politikën i Ambasadës së SH.B.A-ve në Shqipëri

Lorena Diz-Conde – përfaqësuese e Këshillit të Europës në Shqipëri

Artes Butka – Këshilltare e delegacionit të BE-së në Shqipëri

Robert Adams – Ekspert i delegacionit të BE-së në Shqipëri

Florian Hobdari – përfaqësues i OSBE-së në Shqipëri

Erjola Likaj – përfaqësuese e OSBE-së në Shqipëri

Ardita Kolmarku – Drejtoreshë Ekzekutive e Komitetit Shqiptar të Helsinkit

Gerta Meta – Drejtoreshë Ekzekutive e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV)

Rajmonda Prifti – përfaqësuese e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV)

Ermelinda Gjeçi – përfaqësuese e Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV)

Rigers Bena – përfaqësues i Koalicionit të Vëzhguesve Vendorë (KVV)

Afrim Krasniqi – Drejtor i Institutit Shqiptar të Studimeve Politike

Kristaq Kume – përfaqësues i Institutit Shqiptar për Zhvillimin e Sistemit Zgjedhor
(ISHZHSZ)

Premto Gogo – Kryetar i shoqatës “KRIIK Albania”

Dritan Taulla – Zëvendëskryetar i shoqatës “KRIIK Albania”

HAPET MBLEDHJA

Damian Gjijnuri – Mirëdita të nderuar ambasadorë,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës të shoqërisë civile,

Të nderuar përfaqësues të medias,

Në këtë rifillim të punës së Komisionit të Posaçëm Parlamentar për Reformën Zgjedhore, së pari, falënderoj për prezencën anëtarët nga mazhoranca dhe opozita parlamentare.

Ky është një proces shumë i rëndësishëm, gjatë të cilit do të kemi koordinimin dhe mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare, që monitorojnë e mbikëqyrin proceset zgjedhore. I falënderoj për pjesëmarrjen e sotme në këtë takim përfaqësuesit e OSBE-së dhe ata të misioneve diplomatike të akredituara në Tiranë.

Për shkak të interesit që ka për opinionin publik procesi i reformës zgjedhore, puna e këtij komisioni do të zhvillohet në një transparencë maksimale. Falënderoj me këtë rast gazetarët që ndjekin punimet e këtij komisioni e që do të jenë padyshim ata që do të kontribuojnë për këtë transparencë.

Angazhimi im personal me reformen zgjedhore është i hershëm. Më kënaqësi e them se elementi më i rëndësishëm në këtë proces ka qenë e vazhdon të jetë konsensusi sa më i gjerë dhe gjithëpërfshirja.

Në përgjigje të zhvillimeve politike, me synim maksimalizimin e gjithëpërfshirjes, siç ju e dini, ne krijuam dhe një hapsirë për opozitën joparlamentare. Administrata e Kuvendit ka njoftuar Partinë Demokratike për të sjellë një përfaqësues në këtë komision në cilësinë e vëzhguesit me të drejta të plota të bashkëkryetarëve.

Përgjigja e tyre ka qenë publike, në vazhden e qëndrimeve të deritanishme. Kanë zgjedhur të qëndrojnë jo vetëm jashtë Parlamentit, por edhe jashtë procesit të reformës zgjedhore. Natyrisht, për ne do të ishte e preferueshme që ata të sillnin një përfaqësues, siç është sanksionuar në vendimin e ndryshuar të Kuvendit. Gjithësesi, shpresoj se në vijim ata do të mund të reflektojnë duke ndryshuar qëndrim.

Hapësira e krijuar në komision do të jetë deri në fund në funksion të tyre. I garantoj se në punën e këtij komisioni do të gjejnë frymën maksimale të bashkëpunimit për të adresuar të gjitha pretendimet e tyre dhe rekomandimet e OSBE/ODIHR.

Diskutimet dhe propozimet publike nuk kanë munguar për sa i përket reformës zgjedhore, ndaj në bashkëpunim me deputetët e rinj të opozitës në Parlament u dakortësua

për zgjatjen e afatit të punës së komisionit deri më 28 nëntor 2019, në mënyrë që t'i zgjidhim ato dhe për të triumfuuar çdolloj pikëpamjeje, ato do të jenë zgjedhjet e lira dhe të ndershme. Prandaj, përfundimi me sukses i kësaj reforme do të jetë një gur i qëndrueshëm, i rëndësishëm për konsolidimin e këtij procesi, por edhe për zgjedhjet e tjera kurdo që ato të bëhen.

Ne tashmë kemi hyrë në një proces zgjedhor dhe, kuptohet, Komisioni i Reformës Zgjedhore nuk mund të adresojë probleme imediate, që u përkasin zgjedhjeve vendore. Në këto kushte detyra jonë parësore mbetet adresimi i të gjitha çështjeve të ngritura nga misioni i OSBE-ODIHR-it, që i ka vëzhguar zgjedhjet në vazhdim që nga viti 2013, përfshirë edhe zgjedhjet e fundit. Kështu, edhe puna e këtij komisioni, gjithnjë me frymë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë tashmë edhe deputetët e rinj të opozitës, që kanë një pjesëmarrje aktive dhe do të jenë besoj tejet aktivë në këtë proces kaq të rëndësishëm, i cili do të adresojë edhe një nga kërkesat, tashmë të artikuluara publikisht nga një pjesë e mirë e partive opozitare, përfshirë edhe përfaqësuesit e nderuar në këtë tryezë, që ka të bëjë me procesin e sistemit elektoral.

Pavarësisht se sistemi aktual zgjedhor, unë po jap mendimin tim personal, nuk është i keq, nuk mund të themi se sistemi aktual zgjedhor nuk ka prodhuar edhe problematika që duhen adresuar. Megjithatë, nisur nga një thirrje e mbarë aktorëve politikë, pra një pjese të mirë të aktorëve politikë, menduam që kjo çështje të përfshihet, duke plotësuar edhe një nga kërkesat e opozitës për të qenë pjesë e Komisionit për Reformën Zgjedhore.

Nga ana tjetër, kjo punë dhe kjo axhendë, që ne do ta prezantojmë para këtij komisioni sot dhe publikut, do të adresojë, së pari, çështjet më imediate të rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it, për të cilat më vonë unë do të propozoj edhe një axhendë me afate të caktuara se kur mund të ecim me to.

Së dyti, do të adresojë çështjen e votës së emigrantëve, nëse do të ketë konsensus politik. Natyrshëm, votën e emigrantëve e kanë përmendur të gjitha partitë në programet e tyre, madje kanë kërkuar që pjesëmarrja e emigrantëve të jetë aktive në proceset zgjedhore. Natyrisht, kjo kërkon rregulla të caktuara, të cilat duhen materializuar në këtë Kod për t'u bërë të mundura, por, mbi të gjitha, të jenë të gjithëpranuara dhe procesi të jetë me integritet, në mënyrë që të mos kontestohet nga asnjëra palë. Kështu që ky proces do t'i nënshtrohet një konsensusi të gjerë në këtë tryezë të reformës zgjedhore.

Për sa u përket çështjeve të teknologjive në zgjedhje, unë kam pasur eksperiencën time, si drejtues i proceseve të reformës zgjedhore shumë vite më parë, përfshirë edhe kohën kur kemi qenë në opozitë, dhe e di që mendohet sikur teknologjia do të jetë zgjidhja magjike për zgjedhje. Megjithatë, nisur nga vullneti i mirë, pavarësisht problemeve që mund të ketë

teknologjia, ne jemi të hapur që ajo të përfshihet, të eksperimentohet në zgjedhjet shqiptare, por kuptohet, duhet të jetë një gjë e gjithëpranuar dhe, mbi të gjitha, me një proces që ofron integritet, pra të mos kthehet në një tjetër mollë shërri për zgjedhjet. Prandaj duhet një proces i kujdesshëm dhe me teknologji të provuara. Natyrisht, maxhoranca është shumë e hapur për propozimet e opozitës në këtë drejtim.

Gjithashtu, siç e thashë, ndër çështjet që ka kërkuar opozita dhe janë përfshirë në këtë objekt pune është edhe problemi i monitorimit të zbatimit të rekomandimeve që i takojnë qeverisë. Këtu po deklaroj se edhe për zgjedhjet aktuale vendore qeveria shqiptare, edhe me insistimin e anëtarëve të Komisionit të Reformës Zgjedhore, por edhe unë personalisht, nisur nga bisedat që kam pasur me përfaqësues ndërkombëtarë për të treguar, si shumë përfaqësues dhe ambasadorë të nderuar, se edhe qeveria mund të bëjë diçka, pavarësisht nga Kodi Zgjedhor, shumë shpejt qeveria do të kalojë disa masa në lidhje me rolin që do të ketë administrata publike në zgjedhje, lidhur me një ndarje të qartë që ka shteti nga pushteti: zyrtarët publikë nuk do të jenë pjesë e fushatave zgjedhore, si dhe do të ketë një kontroll, me një eksperiencë të ngjashme të mirë të vitit 2017, lidhur me shpenzimet publike në periudhën zgjedhore.

Gjithashtu, dua të përshëndes vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të para një muaji, i cili, në mbështetje edhe të shumë institucioneve ndërkombëtare të ndodhura në këtë tryezë, kaloi një paketë të rëndësishme, siç ishte udhëzimi për transparencën e financimit të fushatës zgjedhore edhe për kandidatët. Këtë publiku duhet ta kuptojë, pra se detyrimet që ekzistojnë për partitë politike do të vlejnë edhe për kandidatët, ku edhe publiku dhe palët e treta do të kenë një sy në këtë proces dhe të drejta ligjore për të kundërshtuar nëse ata shikojnë se gjërat nuk po shkojnë mirë. Në fakt, ky është një hap shumë i madh, revolucionar, nga ku do të dalin realisht detyra shumë të vështira për të gjitha subjektet politike, por edhe për KQZ-në, për ta zbatuar këtë udhëzim.

E përsëris, qeveria do të nxjerrë shumë shpejt vendimet e saj, në mënyrë që shteti të jetë i ndarë nga pushteti. Kjo do të thotë që të mos jetë pjesë e proceseve zgjedhore apo të përdorë burime që ndalohen me ligj në fushatat zgjedhore.

Nga ana tjetër, dua të jap edhe një mesazh, e kam për dijeni ndaj publikut, por edhe për të nderuarit këtu në sallë: në Komisionin për Reformën Zgjedhore përfshijmë edhe përfaqësues të opozitës jashtëparlamentare, të cilët, me vullnetin e tyre, zgjodhën të mos marrin pjesë në këtë parlament, dorëzuan mandatet dhe refuzuan të bëhen pjesë e Komisionit për Reformën Zgjedhore. Madje administrata e Kuvendit iu drejtua zyrtarisht që ata, sipas

vendimit të Komisionit për Reformën Zgjedhore, të kenë përfaqësuesin e tyre, me të drejta të plota, njësoj si bashkëkryetarët e këtij komisioni, që të jetë pjesë integrale e procesit.

Ata kanë refuzuar, përgjigje e cila është bërë tashmë publike, dhe janë në të njëjtat tone dhe linja, sepse nuk e njohin këtë parlament dhe Komisionin për Reformën Zgjedhore. Unë e deklaroj publikisht që ne do të vazhdojmë, pavarësisht mungesës së vullnetit të tyre, por, nga ana tjetër, ata e kanë gjithmonë një vend, një karrige bosh këtu, për të qenë pjesë në çdo kohë që ata e gjykojnë të arsyeshme. Kjo do të thotë se në çdo fazë të kësaj reforme, përpara se ky komision ta përfundojë këtë proces kaq të rëndësishëm, opozita ka të gjitha të drejtat e saj të vijë të propozojë, të vërë veton, të japë argumentet e saj, pse jo, t'u drejtohem i së bashku edhe institucioneve ndërkombëtare për çështje që nuk biem dakord.

Pra, kjo është një ftesë e hapur që ata e kanë në çdo kohë, pavarësisht se kanë zgjedhur një rrugë tjetër, për mua dhe shumë të tjerë, jodemokratike. Mendoj se, herët a vonë, tavolina e vetme ku mund të negociosh rregullat zgjedhore do të jetë kjo tavolinë. Jam i bindur se kjo do të ndodhë një ditë. Ne i mirëpresim, pavarësisht nga retorika politike e çastit.

Së fundi, dua të propozoj disa çështje, që duhet t'i adresojmë me afatet tona kohore. Propozoj, madje kjo çështje ndoshta i përket një debati këtu, që brenda majit të kemi mundësi të adresojmë draftet, tashmë të përgatitura nga një grup i përbashkët ekspertësh gjatë periudhës 2017-2018 të Komisionit për Reformën Zgjedhore, që adresojnë rekomandimet më imediate të OSBE-ODIHR-it. Pastaj, për periudhën e mëvonshme unë kam propozuar disa afate: shtatori mund të jetë për teknologjinë dhe për votën e emigrantëve. Ndërkohë që financimi i partive politike, që është një pjesë e rëndësishme, duhet bërë pjesë e këtij komisioni deri në një afat, si, për shembull, nga fundi i tetorit, si dhe çështjet e sistemit zgjedhor deri në nëntor të këtij viti, në mënyrë që ne të ecim me paketat. Kuptohet, puna do të vijojë paralelisht, por ne t'i vendosim vetes disa afate, ndryshe puna nuk do të përfundojë kurrë. Pra, të kemi mundësi të adresojmë pjesën teknike, ndërsa pjesë që janë më të kontestueshme nga ana politike, për të cilat nuk ka rekomandime të qarta nga ana e ODIHR-it, pasi çështjet e emigrantëve dhe votës së tyre apo probleme të tjera janë më shumë diskrecion dhe sovranitet i vendeve, ne të marrim më shumë kohë, në mënyrë që të gjejmë zgjidhjet e duhura dhe konsensuale. Në fund do të bëjmë edhe emërimin e ekspertëve, çështje që mund ta diskutojmë më vonë.

Po ia kaloj fjalën tani bashkëkryetares, e cila, patjetër, mund të thotë diçka më shumë lidhur me këto. Natyrshëm, uroj të krijojmë një klimë të mirë bashkëpunimi, pavarësisht ideve të ndryshme që kemi, por nisur edhe nga eksperiencat e kaluara, ku së bashku me opozitën (maxhoranca e sotme ishte në opozitë në atë kohë, ndërsa opozita e

sotme, që tashmë jo nuk është më në parlament, ka qenë maxhorancë) kemi ditur të bisedojmë, të gjejmë marrëveshjet e duhura dhe të kalojmë reforma zgjedhore konsensuale, të cilat janë rregullat që ne mundohemi t'i zbatojmë përditë.

Zgjedhjet në Shqipëri janë përmirësuar çdo vit, edhe pse kemi ende probleme, në fakt, si në çdo fushë të jetës, ku nuk mund të përjashtohen zgjedhjet, por mendoj se me vullnet të përbashkët dhe, mbi të gjitha, me klimën e mirë të bashkëpunimit me të gjithë anëtarët e Komisionit për Reformën Zgjedhore, ne do të kemi mundësi të kemi produktin më të mirë.

Patjetër, pjesë e këtij procesi, për efekt të transparencës, do të jenë të gjitha organizatat e interesuara. Gjej rastin këtu të kërkoj mbështetjen e institucioneve ndërkombëtare dhe përfaqësive që janë në këtë sallë, për të na mbështetur me çdo kontributi modest për ekspertizë, në mënyrë që ne të kemi mundësi t'i trajtojmë gjërat edhe në mënyrë profesionale, por, mbi të gjitha, në mënyrë gjithëpërfshirëse dhe transparente. Për shembull, OSBE-ja ka deklaruar zyrtarisht se është e gatshme të ofrojë asistencë për ekspertizë për çështjet e sistemit zgjedhor. Ne e mirëpresim atë dhe do t'i drejtohem zyrtarisht. Por unë do të dëshiroja që edhe donatorë të tjerë, institucione të tjera, nëse e kanë këtë mundësi, le ta bëjnë të vlefshëm për këtë komision, pasi realisht puna jonë e përbashkët është, mbi të gjitha, edhe fryt i të gjithë kontributit që keni ju në tavolinë, pasi të gjithë doni që në Shqipëri të ketë zgjedhje të lira, të ndershme dhe të gjithëpranuara nga palët.

Falënderoj të gjithë anëtarët dhe pjesëmarrësit sot, si dhe ju uroj suksese në këtë punë të rëndësishme!

Fjalën e ka bashkëkryetarja, zonja Rudina Hajdari, së cilës, gjithashtu, i uroj suksese!

Rudina Hajdari – Mirëmbërëma!

Faleminderit, zoti bashkëkryetar!

Të nderuar ambasadorë,

Të nderuar deputetë,

Të nderuar pjesëmarrës të shoqërisë civile,

Të nderuar përfaqësues të medias,

Dua ta filloj fjalën time duke thënë se ndaj një opinion krejt të ndryshëm nga bashkëkryetari i këtij komisioni, por kjo nuk do të thotë se ne nuk do të jemi në gjendje të bashkëpunojmë me njëri-tjetrin, pasi jemi këtu për një arsye të vetme, besoj se flas për Grupin Parlamentar Demokrat, që është ndryshimi i sistemit politik.

Sistemi aktual politik është i dominuar nga antikushtetutshmëria. Mendoj se klasa politike qeverisëse nuk është e përfaqësuar vërtetësisht nga njerëzit, por përfaqësohet në një mënyrë të padrejtë në Kuvendin e Shqipërisë. Mendoj se shqiptarët janë të interesuar për këtë reformë, madje bashkë me grupin tim parlamentar jemi të mendimit se kjo reformë, e cila do të jetë shumë ambicioze, kërkon një vullnet të gjerë politik, në këto tri dekada kemi parë që komisionet e mbledhura nuk kanë prodhuar reforma të mira, por kanë prodhuar zgjedhjet që ne i kemi mirëpritur dhe kemi kohë që luftojmë për zgjedhje të lira dhe të ndershme.

Duke marrë parasysh sfidën e madhe që kemi para nesh dhe nisur nga fakti që jemi ulur këtu sot, bashkë me shoqërinë civile, bashkë me anëtarët e trupit diplomatik, tregon se ka një konsensus të gjerë për të parë dhe diskutuar hapur një diskutim publik për sa i përket ndryshimit të sistemit aktual.

Më duhet të them se zgjedhjet e sotme, që kanë karakterizuar zgjedhjet e viteve 2013, 2015 dhe 2017, siç janë raportuar edhe nga OSBE-ODIHR-i, kanë qenë zgjedhje problematike dhe, në fakt, janë përdorur shumë nga partitë e mëdha tradicionale, si një industri e riciklimit të pushtetit të tyre. Por ndonjëherë sistemi aktual ka gracka të këtij lloji sistemi, që ka mundur ndryshimin dhe rotacionin politik ndërmjet tyre, pa menduar dhe pa i dhënë prioritet popullit shqiptar për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre në mënyrë direkte.

Gjithashtu, mendoj se kemi arritur në një pikë, ku një mandat deputeti kushton gati 1 milion euro. Ky është perceptimi i gjerë në opinionin publik. Pra, duke marrë parasysh që sot nuk mund të futesh dot në parlament pa pasur fonde të caktuara, kjo tregon se ne jemi në një klimë dhe pozitë tejet të vështirë, sepse tregu i zgjedhjeve është kthyer jo në një sistem demokratik, por në treg të zi të shitblerjes së votës.

Duke pasur këtë situatë kaq të vështirë, mendoj se një nga objektivat kryesorë të këtij komisioni është që ne patjetër duhet të jemi të vetëdijshëm se duhet të arrijmë një konsensus politik, i cili mund t'u japë mundësi të gjithë shqiptarëve të përfaqësohen në zgjedhje, por edhe të jenë në gjendje t'i përballojnë, në mënyrë që njerëzit më të mirë dhe më të merituar të vendit të jenë në parlamentin shqiptar.

Më lejoni të ndalem në tri pika ose në tri shtylla kryesore, që ne do të adresojmë gjatë mandatit të këtij komisioni, duke filluar me adresimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it, rishikimin e ligjit "Për partitë politike"... për të krijuar besimin te njerëzit, tek institucionet dhe tek administrata publike, në mënyrë që kjo e fundit të jetë sa më shumë e depolitizuar dhe e pandikuar nga presioni i strukturave politike në vend.

Gjithashtu, gjatë këtij mandati, komisioni do të mundësojë edhe një tryezë të gjerë politike, ku do të shikohen sisteme të ndryshme për të parë një sistem, i cili mund të jetë më i

përshtatshëm për vendin. Patjetër që kjo nuk do të jetë e lehtë, pasi do të kërkojë ndryshime kushtetuese. Këtu do të shikojmë se sa do ta kemi konsensusin politik ndërmjet palëve, madje duhet të jemi të vetëdijshëm për këtë pjesë, sepse ne do të jemi në gjendje ta bëjmë këtë ndryshim.

Mendoj se edhe ekspertët në këtë komision do të jenë të gatshëm për të na ndihmuar në gjetjen e mekanizmave të nevojshëm për t'i arritur këto objektiva.

Gjithashtu, jemi të vetëdijshëm që nuk ka absolutisht asnjëlloj sistemi që është një sistem... por ne duhet të jemi të vetëdijshëm se mund të gjejmë një sistem të pakapur nga kryetarët e partive politike, pra që ua zvogëlon mundësinë këtyre të fundit për të qenë..., por u jep mundësi më shumë përfaqësuesve të jenë të zgjedhur nga populli i tyre.

(Gjatë fjalës së zonjës Hajdari ka probleme incizimi.)

Kështu, mendoj se po t'i arrijmë..., objektivin kryesor të kësaj opozite të re për të qëndruar në këtë parlament, përndryshe besoj se kjo gjë do të ishte e pajustificueshme, duke marrë... nuk është në parlament. Sipas Kushtetutës së Shqipërisë, edhe ata kanë baraspeshën e tyre për t'u përfaqësuar në parlament dhe për të qenë pjesë e këtij reformimi, por është zgjedhja e tyre për të mos u bërë pjesë e reformës zgjedhore, ama synimi ynë kryesor, si opozitë aktuale parlamentare, është që të gjejmë rrugën më të drejtë dhe më të shpejtë për shqiptarët për të arritur disa reforma...

(Shkëputet regjistrimi)

afatgjatë për të garantuar votën e lirë dhe të ndershme për të gjithë shqiptarët.

Faleminderit!

Nëse ka pyetje për axhendën, i ftoj edhe anëtarët e tjerë të opozitës ta marrin fjalën, nëse kanë dëshirë të shprehen në lidhje me...

Damian Gjikhuri – Më falni!

Me lejen tuaj, me konsensus, meqenëse në mbledhjen e parë kemi edhe përfaqësues të nderuar, nëse do të dëshironite ndonjëri nga ambasadorët të jepte ndonjë mesazh, mund ta bëjë!

Kjo nuk është normale për mbledhjet e tjera, sepse natyrshëm ju nuk do të jeni pjesë e mbledhjeve në vazhdimësi, por meqë kemi të bëjmë me çeljen e një procesi të rëndësishëm, që ne nuk e bëjmë dot pa mbështetjen dhe pa mendimin tuaj, pa arsyen tuaj pse rregullat që po bëhen janë të duhurat, unë besoj se, duke rënë dakord, ne mund t'ia japim fjalën me radhë cilitdo nga përfaqësuesit e huaj, që me të vërtetë duan të japë ndonjë mesazh në lidhje me reformën. Kjo nuk është e detyrueshme, por kush e do fjalën, është i mirëpritur...

Besoj se jemi dakord që t'i respektojmë miqtë.

Urdhëroni, zoti ambasador!

Bernd Borchardt - (*Flet anglisht*)

Damian Gjikhuri – Faleminderit, zoti ambasador!

Nëse nuk ka ndonjë përfaqësues tjetër të huaj, ju falënderoj për mesazhet inkurajuese që dhatë!

Fjalën e ka zoti Murrizi, anëtar i këtij komisioni!

Myslim Murrizi – Faleminderit, zoti kryetar!

Së pari, edhe unë ju uroj dhe ju përgëzoj që maxhoranca dhe ju personalisht, u kthyet në rrugën institucionale të funksionimit të komisioneve parlamentare, ashtu siç janë të sanksionuar në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit.

Pashë se Grupi Parlamentar Demokrat apo Grupi i Parlamentar i Pavarur po qëndrojnë në Kuvend, pra nuk iu bindën urdhrimit politik të partive respektive. Ju krijuat një komision 1-mujor (nuk e di se çfarë u bë me atë komision si komision serash), të cilit i latë afat deri më 5 Maj, Ditën e Dëshmorëve, një komisioni parlamentar dhe qytetarëve, që donit të na e sillnit si kushtetues në Kuvendin e RSH-së.

Unë di që në 45 vjet komunizëm ne kemi qenë fener ndriçues dhe kemi hedhur valle në gojë të ujkut, kemi shpikur artifica, ndaj edhe ajo artificë që deshët ta bënit në periudhën 5 prill-5 maj, siç duket u mbyll te varrezat e dëshmorëve.

Do të flas teknikisht 2 fjalë për sistemin zgjedhor dhe për ndryshimet kushtetuese të prillit 2008.

Së pari, modeli zgjedhor që ka aplikuar konsensusi Rama-Berisha në prill 2008 është një model, që në dijeninë time, e ka vetëm Spanja. Ne nuk kemi asnjë lloj ngjashmërie me Spanjën se ajo është monarki, ndërsa ne jemi republikë parlamentare. Do të isha shumë kureshtar të dija pse u gjet pikërisht Spanja si model, që nuk ka kaluar komunizmin si ne, për të sjellë një gjysmë komunizmi të butë në vendimmarrjen politike, që kryetarët e partive parlamentare të jenë sot pronarë të 140 karrigeve të Kuvendit të Shqipërisë.

Së dyti, në bazë të parimeve kushtetuese, shohim se shkelet haptazi barazia e votës së qytetarëve shqiptarë. PD-ja në qarkun e Beratit ka marrë një deputet me 16 600 vota. PS-ja në qarkun e Tiranës ka marrë një deputet me 9000 vota. Partitë e vogla, kur janë pjesë e koalicioneve, në vitin 2013 e kanë marrë një mandat deputeti me 4600 vota, si në Vlorë, edhe në Fier.

Pse qenkan më të përçmuar qytetarët demokratë beratas, ku u dashkan 2-fish vota për një mandat deputeti sesa qytetarët demokratë tiranas, fierakë apo lushnjarrë?

Së dyti, ky ligj ka shtuar arrogancën e kryetarëve të partive brenda subjekteve të tyre politike, ka vrarë demokracinë e brendshme në çdo subjekt politik. Ne nuk është se jemi një vend me demokraci të tepruar, se nuk jemi as Danimarka, as Suedia, as Norvegjia, por ne vijmë nga një regjim që ka pasur një sekretar të parë. Çfarë ka bërë ky ligj? Ka shtuar edhe dy sekretarë të tjerë duke bërë tre sekretarë të parë. Kadri Hazbiu ka qenë deputet në zonën nga vij unë, derisa tradhtoi. Kurse tani, në tri palë zgjedhje kanë ardhur tri palë kadrinjë, jo nga ata që përmend Kryeministri, sepse ky ligj ka rritur amoralitetin e atyre që merren me politikë dhe ka shtuar dozën e hipokrizisë ndaj atij që quhet i zgjedhur nga qytetarët e këtij vendi.

Bëni sot një sondazh me qytetarët shqiptarë, të cilët të thonë se kush është deputeti i zonës së tyre. Nuk e dinë, sepse deputetët, pasi mashtrojnë në fushatë elektorale, ikin si endacakë nga sytë këmbët. Kurse katërvjeçarin e dytë ndërrojnë qark dhe shkojnë atje ku ndihen më rehat, pasi janë jargavitur 4 vjet rresht në paradhomën e kryetarit të partisë. Kjo shton arrogancën e kryetarit të partisë që do të bëhet nesër kryeministër (sot juaji, nesër i PD-së, imi apo i kujt do tjetër), sepse i shikon ato karrige jo si përfaqësues të qytetarëve, por si të emëruar të kryetarëve të partive në Kuvendin e Shqipërisë.

Unë kam qenë deputet në vitin 1997. Jua kam thënë kolegëve të mi në foltoren e Kuvendit dhe po jua them edhe juve, se nuk e ndieni peshën e të qenit drejtpërdrejtë në sistemin maxhoritar dhe nuk e keni provuar se çfarë është peshja e votës së drejtpërdrejtë në emrin tuaj, që nesër në atë foltore të flisni si përfaqësues të atyre që ju kanë votuar. Në emër të cilëve përfaqësues flasim ne? Ju në emër të Ramës dhe ne në emër të Lulit? Po tani që u zemëruam me Lulin, në emër të kujt të flasim? Jemi përfaqësues të popullit apo të partisë? Për përfaqësues të partisë kemi pasur Enverin dhe 5 vjet Ramizin.

Në dhjetor të vitit 1990 unë kam hyrë në protestë si student për të përmbysur një regjim ku Sekretari i Parë ishte pronari i çdo pushteti që buronte nga shumica e kartonëve në atë sallë, kur ka qenë Kryetar Kuvendi një anadollak ...

Ndaj, zotërinj, para se të shkojmë te buzëkuqet që na ka rekomanduar OSBE-ODIHR-i, detajet teknike të Kodit, që për mua nuk kanë asnjëlloj vështirësi, por nuk ka dashur t'i bëj ai që ka qenë në maxhorancë, duhet të merremi me thelbin e problemit, ndryshimin e sistemit zgjedhor. Bollë jemi tallur me shqiptarët në tri palë zgjedhje rresht duke paguar për 12 vjet 380 burra dhe gra në atë sallë duke i quajtur përfaqësues të popullit. Jo, ata nuk janë përfaqësues të popullit. Duhet një sistem ose maxhoritar ose me lista të hapura ... Pranojmë çdolloj modeli të vendeve të nderuara nga kanë ardhur këta zotërinj. Damian, a është prezent ambasadori i Spanjës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ti nuk e ke thirrur ambasadorin e atij vendi nga i cili ke marrë modelin. Të gjitha vendet që kanë përfaqësues këtu nuk e kanë këtë variant.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Po ju pyes si kryetar.

T'i drejtohem zonjës Hajdari?

Unë thashë ta bënim reciproke, ku unë t'ju drejtohem juve, kurse zoti Fino ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dakord. Ti je me mua. Harrova.

Pra, le të votojmë të gjitha detajet teknike për të ashpërsuar Kodin Penal në funksion të mosdevijimit të vullnetit të qytetarëve me intimidim pushteti, me punësime, me banda apo me çeta. Nëse duam ta vëmë gishtin në plagë, unë mendoj se thelbi i kësaj krize politike ku ky vend po hyn dhe ku me urdhër disa dalin në rrugë dhe disa mendohen, është sistemi zgjedhor, ama nëse duam t'u hedhim hi syve shqiptarëve, le ta marrim nismën që sot, i lëmë mandatet dhe u drejtohem me referendum qytetarëve shqiptarë nëse e duan apo jo më këtë sistem. Nëse ata e duan, atëherë unë i pari, por edhe të gjithë ata që kanë folur kundër këtij sistemi, teknikë, media, besoj se do të jenë në të njëjtin logjikë të diskutimit tim dhe atyre që qytetarët na thonë përditë. Nuk kemi pse t'u fshihemi qytetarëve kur duam të flasim në emër të tyre. Kur duam të bëjmë ligjin e qytetarëve, duhet të na votojnë qytetarët.

Thelbi i kësaj krize artificie që ky vend po provon nga viti 2008 deri më sot janë ndryshimet kushtetuese dhe fshehja e të zgjedhurve të zgjedhësve.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Zoti Murrizi, këtë diskutim mund ta kurseje për në një moment tjetër, pasi nisur nga shqetësimet tuaja (është krejt normale që thelbin e çështjes ju e shikoni te sistemi zgjedhor), si dhe nga vullneti i mirë për t'i adresuar këto çështje, këto u bënë pjesë e Komisionit të Reformës Zgjedhore. Patjetër, ju keni pikëpamjen tuaj për sistemin dhe kjo është e mirëpritur. Të gjithë këtu kanë pikëpamjet e tyre dhe kjo është gjë që do të marrë kohën e saj, por edhe rekomandimet e ODIHR-it për standardet kanë shumë rëndësi, sepse shpeshherë ne nuk grindemi politikisht për çështjen e sistemit, por grindemi për problemet e zbatimit të Kodit Zgjedhor.

Nga kjo pikëpamje, fakti që ju mbajtet mandatin tuaj dhe e trajtuat si individual (është i tillë, sepse e njeh Kushtetuta) tregon që kryetarët e partive nuk kanë gjithçka në dorë.

Megjithatë e mbyllim këtë bisedë. Unë mendoj ...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Le të qëndrojmë brenda temës, sepse të gjitha këto tema do të trajtohen. Çështja e sistemit është pjesë e objektit të punës, nuk do ta zgjidhim sot këtu, por ju e shfaqët pikëpamjen tuaj dhe është krejt normale.

Po, zoti Gjoni.

Ralf Gjoni – Faleminderit, zoti Gjoknuri!

Në fakt, doja të flisja edhe unë për sistemin, por zoti Murrizi e qartësoi në mënyrë kaq elokuate dhe kaq të qartë për të gjithë sa që nuk po merrem me detajet e sistemit.

Së pari, dua të falënderoj të gjithë anëtarët opozitës parlamentare për dakordësinë dhe bashkërendimin e aksionit parlamentar, duke ju bashkuar thirrjes sonë për kushtëzimin e prezencës sonë në këtë komision me ndryshimin e objektit të Komisionit të Posaçëm parlamentar për Reformën Zgjedhore, ku të futet edhe ndryshimi i sistemit zgjedhor, përfshirë ndryshimet e nevojshme kushtetuese brenda afatit dhe jetëgjatësisë të këtij komisioni!

Gjithashtu, falënderoj Grupin Parlamentar të Partisë Socialiste që u tregua i gatshëm për të pranuar këtë ndryshim të objektit dhe për votimin në parlament para dy javëve!

Dua të vë në dukje një fakt që më bëri përshtypje sot duke dëgjuar lajmet e BBC-së.

Gjigandi gjerman Porsha, siç i thonë atje, u gjobit sot nga autoritetet gjermane me 600 milionë euro për falsifikimin e rezultateve të testeve të nivelit të ndotjes, kjo përtej manipulimit të softeve apo softëareve të përdorura gjatë këtij procesi, gjithashtu.

Nëse vendi më i fuqishëm ekonomikisht, me një nivel shumë të ulët korrupsioni, arrin të përballet me nivele të tilla hileje korporative, imagjinoni çfarë mund të ndodhë në një vend si Shqipëria, që shpreson se mund të marrë vendimin për hapjen e negociatave këtë vit për t'u bërë anëtare eventualisht e Bashkimit Europian pas disa vitesh.

Rasti i Porshit tregon se natyra njerëzore është e lidhur ngushtë me hilen dhe praktika elektorale në Shqipëri që prej vitit 2008 deri më sot ka provuar se zgjedhjet parlamentare dhe lokale në Shqipëri, janë karakterizuar kryesisht nga hileja në minutën e fundit, nga vendimmarrja në minutën e fundit, nga listat në minutën e fundit, në orën e fundit të natës së fundit para afateve.

Ky komision i posaçëm parlamentar ka kaq vite që vetëm shtyn afatin e tij dhe nuk prodhon asnjë reformë substanciale elektorale. Dua të theksoj dhe do ta ritheksoj në çdo takim të këtij komisioni, kjo të jetë e qartë edhe për partnerët tanë ndërkombëtarë, për të cilët jam shumë mirënjohës që janë këtu sot, që ne jemi dhe do të jemi në këtë komision për sa

kohë që ndryshimi i sistemit zgjedhor trajtohet paralelisht me të gjitha çështjet e tjera që lidhen me adresimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it. Le t'i adresojmë rekomandimet e OSBE-ODIHR-it. Ne kemi një pjesë tonën këtu në parlament. Qeveria ka një pjesë shumë të madhe, e cila mund t'i kishte bërë dhe ju përshëndes për atë që thatë, që shumë shpejt qeveria do të marrë ose do të paraqesë një sërë masash, si pastrimi i listave elektorale, falsifikimi i dokumenteve e të tjera, edhe pse duhet t'i kishte bërë me kohë. Përgjithësisht janë të qeverisë, të ekzekutivit, jo të parlamentit. Jam mirënjohës, gjithashtu, që në objekt keni futur edhe të drejtën për të thirrur për llogaridhënie ekzekutivin dhe institucionet shtetërore që merren me mbarëvajtjen dhe procesin zgjedhor. Prania jonë këtu, dhe besoj se flas në emër të të dyja grupeve, edhe të deputetëve të opozitës, anëtarë të këtij komisioni, lidhet ngushtë me zëvendësimin eventual përmes ndryshimit të komponentit hile me komponentin besueshmëri. Asnjë zgjedhje në Shqipëri, sidomos 2-3 zgjedhjet e fundit parlamentare, nuk janë karakterizuar nga besueshmëria. Përkundrazi, janë karakterizuar nga mungesa e besueshmërisë, nga hilja, nga shitblerja, nga vjedhja e votës, nga intimidimi, nga hilja brenda partive politike, nga mungesa e besimit, duke filluar që nga kandidatët që janë nëpër lista deri te kryetarët; që nga blerja e vendeve për kandidatë për deputetë në listat e disa partive politike (kjo blerje e vendit të kandidatit në listat për deputetë nuk është hetuar asnjëherë nga institucionet përgjegjëse); që nga hilja që kryetarët u bëjnë kandidatëve; që ka presioni që kandidatët për deputetë kanë nga kryetarët, nga bajraktarët ose nga pronarët e listave. Kjo duket qartë edhe sot në parlament nga votimi parlamentar që bëhet me *WhatsApp*, pra nuk bëhet as me integritet dhe as me pavarësi personale, por vetëm përmes urdhrave.

Atëherë, unë jam shumë mirënjohës për bashkëpunimin ose shpirtin e bashkëpunimit që është treguar sot në këtë mbledhje, pra që kemi arritur këtu, por mbetem skeptik për sa i përket trajtimit serioz dhe substancial të çështjeve që lidhen me ndryshimin e sistemit zgjedhor.

E përsëris, nëse nuk ndryshohet sistemi, e them këtë edhe për qytetarët që na ndjekin *live*, prezenca jonë si opozitë jo vetëm në këtë komision, ky është mendimi im personal, por as në këtë parlament nuk do të bënte më sens.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Urdhëroni, zoti Fino!

Bashkim Fino – Faleminderit, bashkëkryetar!

Kam përshtypjen se ne jemi sot në mbledhjen e parë të Komisionit të Reformës, por mendoj se nuk e filluam siç duhet. Nuk do të flisja, por mora shkak nga parafolësi që bëri një diskutim, ashtu siç e mendoi. Çfarë është partia?! Partitë politike në Shqipëri janë krijuar si

organizata, duke u mbështetur në dy shtylla, në programin dhe në statutin e tyre. Tani duam apo nuk duam, ne jemi shumë të organizuar dhe e dimë se çfarë është partia. Këtu nuk mund të bëjmë dot histori dhe të tregojmë besueshmërinë, pavarësinë personale në raport me partinë dhe me drejtimin e partisë. Unë jam një nga ata deputetet e vjetër, si Myslim Murrizi, që i kam provuar të dyja sistemet, edhe sistemin maxhoritar të pastër, pra 100 deputetë dilnin nga një maxhoritar i pastër dhe 40 të tjerë dilnin nga partitë e tjera mbi bazën e përqindjes, edhe sistemin e sotëm proporcional rajonal.

Në të dyja rastet, po të drejtohem ty, zoti Gjoni, të jesh i bindur që drejtimi i partisë ka vlerë të jashtëzakonshme. Në rastin kur ti do të vësh kandidaturën për deputet në një sistem maxhoritar të pastër, natyrisht që do të marrësh një vulë nga partia ku bën pjesë. Unë vërtet vendos emrin tim si Bashkim Fino për deputet në një sistem maxhoritar të pastër, por duhet të kem mbështetjen e një force politike që të vazhdoj. Pra, pse e thashë këtë gjë?! E thashë për të treguar që nuk është marrëveshja e prillit 2008 “Rama–Berisha” që e prishi sistemin. Ky është një nga sistemet që e kanë shumë vende në Europë. Disa vende në Europë kanë edhe sisteme të tjera, meqenëse gjithmonë u drejtohem të huajve dhe marrim mendimet e tyre. Ka sistem proporcional të pastër në të gjithë Republikën e Shqipërisë, natyrisht, me një prag 5% apo 6%, sepse nuk mund të futen parti me 1% apo 2% në parlament. Hajdeni ta bëjmë edhe këtë, sepse edhe kjo është një formë sistemi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem, të dëgjova me kënaqësi dhe nuk të ndërhyra!

Dua të them se ne sot këtu kemi një anxhendë. Fatmirësisht bashkë me disa kolegë të maxhorancës kemi qenë anëtarë të Komisionit Zgjedhor të Reformës edhe para se të krijohej ky komision, të cilin ju e përshëndetët me të drejtë, dhe jam plotësisht dakord që këtu respektohet Kushtetuta. Ju jeni deputetë të opozitës dhe duhet të jeni ju në këtë komision. Kjo është një gjë shumë e mirë, por të mos harrojmë që nuk duhet hedhur poshtë puna njëvjeçare që ka bërë komisioni i mëparshëm, sepse kemi një draft me nene të caktuara, me problematika të caktuara, të cilat i kanë ngritur OSBE/ODIHR-i, partitë politike, partia jote e LSI-së, partia ime e PS-së dhe partia e PD-së. Pra, të gjitha partitë me radhë, pavarësisht se ato janë jashtë. Këto problematika ne i kemi pasqyruar për 1 vit në këtë draft. Unë nuk mendoj se ky draft duhet hedhur poshtë.

Zoti bashkëkryetar, mendoj se ky draft që kemi në dosje, duhet të rishikohet nga të gjithë anëtarët, bashkë me anëtarët e rinj, të cilët kanë ardhur në komision për të dhënë dakordësinë për shumë nga nenet e tyre, më pas për të diskutuar sipas këtij plani pune që kemi këtu, në fund të fundit, edhe për sa i përket sistemit zgjedhor.

Pra, më lejoni të them se jam plotësisht dakord me ju, zoti Gjijnuri dhe me bashkëkryetaren, kur thatë: “Ky është komisioni legjitim kushtetues, por të mos harrojmë edhe partitë që janë jashtë”.

Ju sot jeni deputet i pavarur, ju sot flisni si deputet i pavarur, apo jo? Atëherë, unë jam i detyruar, për shkak të zgjedhjeve, të dëgjoj se çfarë mendimi ka edhe LSI-ja që është jashtë. Zotërinjtë këtu janë deputetë të Partisë Demokratike dhe e pranojnë që janë grupi i ri parlamentar i PD-së, pavarësisht problemeve që kanë, të cilat nuk më interesojnë, por jam i bindur se kanë dy mendime, një mendim që sapo e thanë këtu bashkëkryetarja dhe kolegu Myrrizi, por dhe mendimi që mund të ketë Partia Demokratike jashtë. Domethënë, ne duhet të bëjmë një Kod Zgjedhor të përafuar, të besueshëm ashtu siç e thatë edhe ju, me pavarësinë personale për të votuar, pra për të pasur një Kod më se real.

Dua t’ju them bashkëkryetarëve se nuk kam asnjë vërejtje me planin e punës që keni paraqitur këtu dhe me afatet konkrete. Shpresoj dhe besoj t’i realizojmë këto afate brenda kohës, duke pasur parasysh që fillojnë edhe pushimet në korrik dhe gusht. Vërtet shpresoj që brenda 28 Nëntorit, në Festën e Flamurit, të kemi përfunduar 4 nga çështjet kryesore dhe më thelbësore që kemi marrë parasysh këtu. Çështja e sistemit është një çështje për t’u diskutuar dhe ka mendime nga më të ndryshmet.

Së fundi, zonja bashkëkryetare, ju lutem, kur jepni shifra, mundohuni të jeni pak e qartë! Më vrau veshin kur thatë: “Një deputet është baras me 1 milion dollarë”.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Në fund të çdo vit do të keni rastin edhe ju që jeni deputetë të rinj të merrni një vërtetim nga financa e parlamentit shqiptar ku do të pranoni sa të ardhura keni marrë gjatë një viti. Ka institute që kanë bërë shumë studime dhe të gjithë deputetët, pa përjashtim të majtë dhe të djathtë, nuk marrin më shumë se 20 milionë lekë të vjetër në vit bashkë me shpërblimet, me pagat dhe të gjitha me radhë. Domethënë, një deputetë në 4 vjet nuk harxhon më shumë se 80 milionë lekë të vjetër të ardhura. Zonjë, deputeti shqiptar është më i diskriminuari në raport me deputetin e rajonit, po marr vendet e rajonit që i kemi këtu afër, si Maqedoninë, Malin e Zi, Serbinë apo Kosovën. Krahasoje deputetin e Kosovës me deputetin shqiptar nga pikëpamja financiare! Është si nata me ditën. Në qoftë se në gjuhën tuaj, në gojën tuaj, është shprehja “Një deputet baras me 1 milion euro”, imagjinojeni perceptimin e publikut. Publiku duhet ta dijë se deputeti shqiptar gjatë një viti punë kalendarike nuk merr më shumë se 20 milionë lekë të vjetër; në 4 vjet i thonë 80 milionë lekë të vjetër, por jo 1 milion euro, sepse kjo është një diferencë e madhe. Prandaj, ndonjëherë ne nuk ecim përpara siç duhet, sepse miratojmë struktura të institucioneve institucioneve kushtetuese e ligjvënëse,

të cilat varen nga ne si deputetë, me kushte financiare dhe me paga shumë herë më të larta. Këtë shqetësim e kam ngritur disa herë në parlament. Pra, kanë paga më të larta se deputeti shqiptar, por përsëri perceptimi ngelet negativ për deputetët. Pse?! Sepse ne nuk jemi në një zë të gjithë dhe të themi: “Stop, asnjë institucion i krijuar nga ne rishtazi nuk do të marrë pagë më të lartë se Presidenti i Republikës”. Kur miratojmë buxhetin e shtetit, miratojmë një nen të caktuar. Për shembull, neni 15: “Paga e Presidentit të Republikës është 225 mijë lekë të rinj”. Domethënë, në hierarkinë e pagave ajo është paga më e lartë dhe pas asaj page vijnë të gjitha pagat e tjera. Po ta krahasoni me shumë institucione që miratojmë dhe zgjedhim këtu, ato janë 100 herë më të larta. I thashë këto, që edhe ne të mos japim më shembuj të tillë, sepse edhe ne vetë krijojmë perceptime të tilla te publiku. Jo, moj zonjë, jo, nuk merr kurrë 1 milion dhe nuk do të arrijmë kurrë të marrim 1 milion euro. Shpenzimi i një deputeti është ai që thashë.

Faleminderit!

Damian Gjijnuri – Faleminderit, zoti Fino!

Të lutem, ta mos e kthejmë këtë në një seancë debati, sepse nuk shkon.

Së pari, ky është një komision pune, domethënë ka një axhendë konkrete për të adresuar disa probleme. Pavarësisht nga opinionet e ndryshme politike që kemi në këtë tavolinë, nuk është vendi që t’i shpalosim ato, sepse kemi hapësira sa të duam në sallën parlamentare, ku të gjithë kanë mundësi të shpalosin pikëpamjet e tyre politike. Natyrisht, mendimet për çështje, të cilat lidhen me problemet e reformës zgjedhore dhe që kanë konsiderata politike, ju do t’i shprehni këtu.

Të nderuar kolegë, ju lutem, pavarësisht nga emocionet politike që keni në lidhje me sistemin, të gjithë jemi produkt i këtij sistemi zgjedhor. Ne bashkë kemi rënë dakord që të punojmë dhe ta ndryshojmë këtë sistem zgjedhor, por kjo nuk bëhet me deklaratatë. Ne kemi një axhendë pune për të sqaruar publikun dhe të gjithë të ftuarit këtu.

Diktimi i disa afateve bëhet jo vetëm që të imponojmë një axhendë për veten tonë, por, nisur edhe nga rëndësia e problemeve, siç e tha edhe kolegu Fino, për ecurinë e punës së bërë, sepse është bërë një punë e mirë, e cila nuk ka marrë konsensusin e komisionit për shkak se Partia Demokratike braktisi komisionin, atëherë, të gjithë anëtarët kanë mundësi për një periudhë gati 1 mujore, të njihen me punën e bërë dhe ta përmirësojnë atë. Ne kemi ekspertët për të ndryshuar atë që duhet, në mënyrë që paketën e parë ta kalojmë në mënyrë konsensuale. Pavarësisht sistemit, unë po e them edhe si njohës i sistemeve zgjedhore, asnjë sistem nuk është i barabartë me peshën e votës, nuk ka sistem që të jetë peshore, siç e duam ne elektronike, për peshën e votës. Çdo sistem ka devijimet e tij për peshën e votës, por ajo

që i dallon zgjedhjet e mira nga të këqija janë standardet dhe respektimi i barabartë i rregullave të lojës sesi zbatohet legjislacioni zgjedhor. Kjo është ajo për të cilën grindemi dhe nuk është çështja e ndarjes së mandateve.

Nuk kam pse t'i përsëris edhe një herë ato që u thanë, por nuk duhet ta kthejmë këtë në një mollë shërri. Do të kemi kohë të debatojmë dhe t'i shikojmë të gjitha sistemet. Unë propozoj që ne të ecim me këtë axhendë pune.

Duhet të keni diçka parasysh. Nuk është e thënë që ne do ta miratojmë paketën në qershor dhe ta çojmë në Kuvend e ta miratojmë, por në këtë paketë të dakordësuar do t'ia çojmë ODIHR-it dhe KE-së dhe do të marrim opinionet e tyre.

Për sa u përket standardeve, ne e kemi të pastruar, domethënë kemi diçka të vetuar nga pikëpamja juridike, ndërkohë vazhdojmë me çështjet e tjera, atë të emigrantëve, e cila është çështje diskrecionale e vendit. ODIHR-i nuk ka rekomandim për çështjet e emigrantëve dhe të teknologjisë, ashtu siç nuk ka kurrë rekomandime për sistemet zgjedhore. Sistemet zgjedhore janë si puna e një familjeje që vendos të dekorojë apo të ndërtojë shtëpinë sipas rregullave apo dëshirave të saj dhe nuk të imponon njeri me standardet. Pra, kështu është edhe çështja e sistemit zgjedhor. Ajo për të cilën ne jemi mbledhur janë standardet, sistemi është pjesë e punës dhe ju lutem mos e ktheni këtë çështje në debat, kjo edhe për respekt të të ftuarve!

Ata që duan ta marrin fjalën duhet të fokusohen në këto tema dhe të mos përsërisim njëri-tjetrin në lidhje me gjëra që kemi rënë dakord. Pastaj vazhdojmë me çështjet e tjera, që do të ecin paralel.

Rudina Hajdari - Më falni, por ne duhet të jemi sa më të logjikshëm dhe, meqenëse jemi bashkëkryetarë, duhet të flasim në mënyrë të barabartë.

Dua t'i përgjigjem zotit Fino, meqenëse m'u referua. Zoti Fino dhe të gjithë anëtarët e tjerë duhet të kenë shumë durim, sepse jemi dy krahë të ndryshëm dhe do të kemi debate për sa i përket sistemit, mekanizmave të ndryshëm që do të propozojmë dhe të gjitha objektivave që do t'i vëmë vetes, në mënyrë që të kemi një sistem politik të mirë, sepse edhe ju, zoti Fino, jeni i vetëdijshëm që ky është një sistem politik i kalbur. Fakti që ju thoni se partitë politike janë të rëndësishme, është e vërtetë, por nuk e kemi tagrin të dalin para popullit dhe t'u themi se sa të mbështetur jemi ne sot. Nëse unë kam pranuar të jem pjesë e këtij sistemi, e kam bërë sepse nuk kisha mundësi tjetër, por për atë që po luftojmë ne sot, është që të dalim para popullit dhe t'u themi se kush peshon më shumë në këtë sallë. Kjo besoj se do të ishte një luftë e denjë për të gjithë deputetët, të cilën duhet ta mbështesim.

Së dyti, duhet të jemi të vetëdijshëm se kryetarët e të gjithë krahëve politikë, kryetarë bashkish dhe deputetë kanë vite me radhë në këtë parlament dhe vetëm orët që vënë dhe makinat poshtë që i presin mund të krijojnë 20% të PPP-ve të Shqipërisë. Besoj se këto mjete që posedojnë dhe ato që veshin nuk justifikohen me rrogat që marrin nga Kuvendi i Shqipërisë. Nuk dua të etiketoj njeri, por ky është realiteti shqiptar dhe ne duhet të jemi të vetëdijshëm për këtë, nuk ka pse t'ju vijë keq fare, sepse, në fund të fundit, duhet të jemi të sinqertë. Trupi diplomatik besoj se është i vetëdijshëm për këtë gjë.

Një nga arsytet që jemi këtu dhe që mendojmë se reforma në drejtësi është e rëndësishme, është që do të luftojë korrupsionin në vend, i cili buron edhe nga partitë politike. Duke pasur parti politike të sanksionuara, sipas Kushtetutës, transparente dhe të kemi një tavan për shpenzimet e çdo kandidatëve...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk thashë se sa lekë fiton deputeti, por sa kushton një mandat deputeti, që është gati 1 milion euro. Pra, lekët, që ata përdorin, ua japin kryetarëve të partive, apo elektoratit që t'ua mbushin mendjen...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Besoj se nuk është etike që të më drejtoheni në këtë mënyrë, sepse nuk ka pse t'ju vijë keq. Nuk thashë që ndodh vetëm në një krah politik, por ka ndodhur nga të gjitha krahët. Kështu që mos u shqetësoni për këtë gjë. Unë mendoj se një ditë ne do ta shikojmë këtë problem...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk keni pse shqetësoheni fare, sepse këto probleme i dinë të gjithë shqiptarët.

Bashkim Fino – Nuk jam i shqetësuar, moj zonjë...

Rudina Hajdari - Jeni i shqetësuar, sepse shoh që po ngrini zërin.

Damian Gjijnuri – Zonja Hajdari, ju lutem!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Rudina Hajdari – Zoti Fino, kam shumë respekt për ju, sepse keni një eksperiencë të gjatë në politikë...

Damian Gjijnuri – Zonja Hajdari, si bashkëkryetare e këtij komisioni, nuk ju takon të flisni kështu, sepse ne jemi këtu të mbajmë ekuilibrat e kësaj sale dhe duhet të fokusohemi tek takimet e punës. Akuzat politike janë të shumta. Sa për dijëni, Kodi Zgjedhor ka disa pika për financimin zgjedhor dhe nuk mund t'i tejkalojmë. Megjithatë, çfarëdo propozimi që keni, nisur nga konsideratat që keni, ju mbi të gjitha si bashkëkryetare, të jeni në gjendje t'i sillni këtu dhe t'i diskutojmë. Kështu që, në respekt të të ftuarve që kemi dhe të

kësaj seance të parë, do të kemi mundësi të debatojmë herë tjetër me njeri-tjetrin. Unë them le të fokusohemi tek tema e punës, të flasim edhe anëtarët e tjerë, në mënyrë që të fillojmë punën. Adresimi më i mirë janë veprat dhe jo fjalët. Po folëm duke akuzuar njeri-tjetrin dhe të mos bëjmë asnjë produkt, na rroftë që ne bëritëm në këtë sallë.

Rudina Hajdari – Për ta mbyllur, ashtu siç ju akuzoni deputetët e rinj që nuk kanë eksperiencë dhe nuk i njohin sistemet, edhe ju duhet të kuptoni perceptimin e jashtëm sesi ju shikojnë ju njerëzit jashtë politikës. Këtu nuk kam ardhur të flas për raporte, por për perceptimet e mia dhe kam të drejtën time të shpreh mendimet e mia për problematikat në Shqipëri dhe sistemin aktual politik.

Zonja Bushka, fjala për ju.

Klotilda Bushka – Të nderuar bashkëkryetarë,

Të nderuar kolegë,

Të nderuar përfaqësues të trupit diplomatik, përfaqësues të shoqërisë civile,

Mua më vjen mirë që rinisëm punën e Komisionit të Reformës Zgjedhore, i bllokuar prej disa muajsh, pas një pune kolosale të bërë. Si mbledhje e parë duhet t'i rikujtojmë njeri-tjetrit që ky komision që në krye të herës u ngrit me qëllim të vetëm: të rikthejmë besimin e publikut te procesi zgjedhor. Ky është qëllimi sublim dhe më i madh që ka komisioni. Për të arritur këtë qëllim e pamë si të domosdoshme që në objektin e punës së komisionit të vendosnim adresimin e të gjitha rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it dhe të partnerëve ndërkombëtarë në zgjedhjet e mëparshme, 2013, 2015, 2017. Kjo punë i shkon për shtat rritjes së standardeve dhe përcaktimit të atyre standardeve në proceset elektorale, siç rekomandohet nga ekspertët e Komisionit të Reformës Zgjedhore, të cilët prodhuan një sërë aktesh, dhe rritin besimin e publikut te procesi zgjedhor. Nga ky parim duhet të nisemi të gjithë, sepse, nëse e harrojmë këtë qëllim, do të përhapemi në degë të ndryshme dhe nuk do të shkojmë tek arsyeja e hershme e kësaj pune.

Kështu, unë dua të falënderoj të gjithë ekspertët që punuan në pjesën e parë të punës së këtij komisioni, kur ky komision kishte në përbërje kolegë të tjerë të opozitës, kurse sot ka kolegë të rinj të opozitës, të cilët me ndihmën e OSBE-ODIHR-it dhe të ambasadës gjermane hartuan një sërë aktesh, të cilat janë shumë të vlefshme për të adresuar të gjitha rekomandimet që u dhanë për rritjen e standardeve në proceset elektorale. Më pas të mbajmë në konsideratë jo vetëm këtë punë, por edhe punën e kryer për mundësimin e votës së emigrantëve, punës kolosale të bërë për financimin e fushatave zgjedhore, të standardeve që duhen ndjekur në këto çështje, si çështjen e depolitizimit të organeve të zgjedhjeve dhe çështje të tjera shumë të rëndësishme që kanë të bëjnë me menaxhimin zgjedhor. Pa diskutim

që çështja e sistemit zgjedhor është një çështje, e cila me dakordësinë e maxhorancës u pranua të jetë objekt i punës së këtij komisioni, sepse në si maxhorancë jemi të hapur për një debat gjithëpërfshirës me partitë parlamentare, por edhe me ato që nuk janë në parlament për të kuptuar nëse sistemet elektorale, që mund të jenë të aplikueshme në vende të tjera, janë më të suksesshme se ato në Shqipëri, janë gjithëpërfshirëse dhe mund të sjellin rezultate më të mira. Le të nisë ky debat, por nuk mendoj se ky është debati primar që ne të arrijmë qëllimin e komisionit. Qëllimi është të kthejmë besimin e publikut te sistemi zgjedhor. Përveç kësaj çështjeje, çështjet primare, që arrijnë të kthejnë vëmendjen tonë te qëllimi i rritjes së besimit të publikut te vendimmarrja, lidhen me përcaktimin e standardeve të qarta, të garancive në zgjedhje, ashtu siç përcaktohet në të gjitha aktet ndërkombëtare dhe siç na është ofruar nëpërmjet ekspertizës nga partnerët tanë ndërkombëtare, në mënyrë që pas shumë kohësh ky komision të arrijë në një përfundim real dhe efektiv, që është edhe qëllimi për të cilin u ngrit. Në këtë kuadër, dua të them se axhenda e punës së komisionit së bashku me afatet që keni paraqitur si bashkëkryetarë i përkon qëllimit të komisionit. Unë shpreh dakordësinë time në lidhje me këtë, duke u bashkuar me mendimin e kolegut Fino, që puna e mëparshme e kryer nga komisioni të vazhdojë të jetë pjesë e punës së komisionit dhe të ecim para me çështjet e tjera për elaburimin e tyre.

Për sa u takon diskutimeve të tjera që jemi duke bërë, është mirë që, si në çdo komision reformash dhe si në çdo bisedë reformash, të kemi në konsideratë dy gjëra kryesore: çdokush duhet të jetë i lirë të shprehë mendimin e tij dhe unë ju lutem që ky mendim të jetë brenda çështjeve të rendit të ditës, sepse kështu do të fokusohemi te shërbimi që kemi ndaj qytetarëve; e dyta, nuk ka reformë me sukses, nëse nuk ecën me sinqeritet. Mendoj se kompozimi i këtij komisioni i plotëson të gjitha kushtet për një reformë të sinqertë dhe të qartë midis nesh. Për më tepër që kemi fatin e madh që partnerët ndërkombëtarë, që na kanë monitoruar gjatë proceseve zgjedhore, janë këtu për të na dhënë ekspertizën e tyre që ky proces të shkojë në shinat e duhura.

Kështu që ju faleminderit dhe punë të mbarë të gjithë komisionit!

Damian Gjikhuri – Fjalën e ka zoti Musaj.

Nimet Musaj – Faleminderit, zoti Gjikhuri dhe zonja Hajdari!

Të nderuar kolegë të komisionit,

Të nderuar ambasadorë të trupës diplomatike,

Të nderuar anëtarë të shoqërisë dhe pjesëmarrës,

Sot është një ditë e shënuar, sepse për herë të parë në një tryezë të tillë po flitet hapur, me transparencë dhe po merret në konsideratë një sistem zgjedhor 30-vjeçar dhe sot jemi në këtë pikë.

Në emër të grupit, dua të them se jemi këtu jo vetëm për të qenë faktorë për ndryshimin e sistemit, por të bëhemi faktorë që një votim transparent, i barabartë, ku të lexohet vota e çdo qytetari, të jetë jo vetëm në të mirë të vendit, por që ne pas 30 vjetësh të mos merremi më faktin nëse shqiptarët kanë votuar drejt apo nëse u është shtrembëruar vota e tyre. Nuk do të hyj shumë tek teknikalitetet, sepse, po të shohim draftin që kemi këtu, ai nuk i adreson të gjitha rekomandimet e OSBE-ODIHR-it dhe nuk është i plotë. Kemi vite që flasim, 2013, 2015, 2017 për disa rekomandime të rëndësishme dhe të qenësishme të OSBE-ODIHR-it dhe në komisionet e mëparshme nuk janë marrë në konsideratë. Është ky Kod dhjetëvjeçar, eksperimental, për mendimin tim, që sot kemi një President të zgjedhur nga Kuvendi, që sot është e vështirë që një qytetar i pavarur të kandidojë për deputet dhe kryetar bashkie. Ka vite që është folur për teknologji të ndryshuar, por nuk është bërë. Cilat janë arsyet që nuk janë bërë këto?! Cili ka qenë vullneti i komisioneve për të mos i realizuar ato?

Mendoj se ne të gjithë si anëtarë të komisionit me një marrëdhënie konsesuale ndoshta do t'u japim atë që u ka munguar shqiptarëve: votën e lirë. Është e drejta jonë dhe e forcave PD dhe LSI të japim argumentet së bashku me grupet e interesit, me akademikët, me qytetarët, pra të ketë një gjithëpërfshirje të madhe që të mos merremi më dhe t'i kthehemi gangrenës së madhe të votimit të padrejtë. Ka pak ditë që mbaruan zgjedhjet edhe në shtetin fqinj. Në mëngjes u shpalla kandidatura fituese për President, kurse neve na është dashur 1 javë apo 10 ditë për të nxjerrë një rezultat pozitiv. Nuk dua të hyj në shumë fenomene që ka ndodhur.

Falënderoj kolegët për diskutimet! Jemi këtu si Grup Parlamentar i Pavarur bashkë me Grupin Parlamentar demokrat, natyrisht, edhe me eksperiencën e kolegëve të maxhorancës për të sjellë pranë qytetarëve të Shqipërisë jo vetëm ndryshimin e sistemit, por një kod që ndoshta në të ardhmen qytetarët shqiptarë do të zgjedhin, dhe e meritojnë, atë që ata mendojnë.

Ju faleminderit!

Damian Gjikhuri – Faleminderit!

Zonja Hysi, ju lutem shkurt, nëse mundeni.

Vasilika Hysi – Shumë faleminderit! U uroj të dy bashkëkryetarëve suksese, me besimin që puna e nisur gati një vit e gjysmë më parë do të finalizohet!

Të nderuar bashkëkryetarë, do të doja të kalonim te miratimi i rendit të ditës, sepse po shkojmë drejt mbylljes së mbledhjes dhe ende nuk është miratuar rendi i ditës, për të cilin unë u shpreh dakordësi. Njëkohësisht, dua të ndaj me ju edhe një sugjerim. Meqenëse ky komision ka 6 muaj punë dhe 1 muaj pushim, lidhur me pikën e parë për reflektimin e rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it, që është lënë afati deri në datën 30 qershor të vitit 2019, të kishim një kalendar të detajuar për të pasur një punë sistematike në lidhje me ecurinë për përmbushjen e pikës së planit, por të punuar paralel, sikurse kërkojnë edhe kolegët e opozitës, për tri çështje të tjera, të cilat duan kohë dhe konsultim.

Këtë ndërhyrje procedurale kisha, pra miratimin, në radhë të parë, të rendit të ditës, të planit të punës së ekspertëve dhe të kërkesës për mbështetje me ekspertizë nga OSBE-ja lidhur me sistemin zgjedhor, duke adresuar të gjitha shqetësimet e kolegëve të opozitës.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri - Zonja Hysi në lidhje me shqetësimin që ngrini, besoj se këtu po flas në emër të të gjithëve, sepse nuk ka ndonjë gjë të veçantë me emërimin e ekspertëve sot. Shumë shpejt ata do të vijjnë, nisur nga produkti tashmë një pjesë e mirë e bërë, siç u tha edhe nga kolegët, me propozime konkrete lidhur me axhendën. Unë mendoj se në bashkëpunim me bashkëkryetaren ne mund të vendosim një axhendë të detajuar.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Gjoni folët një herë!

Një sekondë, ta mbaroj!

Pra, do të thotë që do të kemi një axhendë të detajuar dhe me data lidhur me ato që do të adresojmë: çështjet e formimit të administratës zgjedhore, problemet e financimit të zgjedhjeve, të gjitha problemet që janë pjesë e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it. Le të mbarojmë edhe raundin e diskutimeve të anëtarëve dhe pastaj të shkojmë te pika e fundit, ku do të votojmë edhe axhendën, edhe pyetjet në lidhje me këtë të fundit.

Po, zonja Gjylameti.

Blerina Gjylameti – Mendoj se duhet të jemi pak më korrektë në fjalën që ju japim, meqenëse jemi në numër të barabartë ndërmjet anëtarëve të opozitës dhe anëtarëve të maxhorancës. Radhën tashmë e ka zoti Lita, meqenëse është përfaqësues i opozitës. Unë e kam kërkuar, me thënë të drejtën fjalën para 3 kolegëve, por po ia lë radhën zotit Lita.

Korab Lita –Faleminderit!

Të nderuar bashkëkryetarë,

Të nderuar anëtarë,

Të nderuar të ftuar,

Kam diçka më koncize, sepse u shpërndamë pak në diskutime. Ne jemi të gjithë dëshmitarë se komisionet e përkohshme që janë krijuar gjatë viteve në parlament, në shumë raste kanë dalë pa ndonjë rezultat konkret, kanë dalë me dy variante, kur janë bërë me bashkëkryetarë. Unë nuk do të doja të isha pjesë e një komisioni që të përfundonte si komisionet e para.

Teknikalitetet duhet t'ua lëmë ekspertëve. Ne duhet të jemi më koncizë në ato që themi. Ne, deputetët e opozitës, të Grupit të Pavarur kemi parashtruar në parlament dhe këtu një pikë që e quajmë shumë të rëndësishme, se Shqipëria ka 30 vjet që po vuan nga ky sistem: janë çështjet e hapjes së diskutimit për ndryshimin e sistemit zgjedhor të cilin ju e futët në rendin e ditës së komisionit. Shikoj se nuk e keni futur në planin e punës. Ndoshta është modeli i hiles, që tha zoti Gjoni. Pavarësisht se është radhitur e fundit, ajo është e rëndësishme dhe duhet të jetë menjëherë me rekomandimet. Nuk thuhet askund hapja e diskutimit publik për çështjen e ndryshimit të sistemit zgjedhor. Thuhen gjëra periferike, por nuk janë koncize. Unë dua që kjo të jetë koncize në planin e punës dhe të fillojë që tani, pasi ky është një diskutim shumë i gjerë, një diskutim që kërkon kohë, kërkon diskutim me grupet e interesit dhe nuk do të doja që ky lloj diskutimi të miratohet pastaj të fillojnë diskutimet nëpër televizione. Unë dua të bëhen të gjitha diskutimet dhe kur të arrijmë në një marrëveshje të mos flasë askush më, por vetëm të zbatohet, sepse praktika e miratimit të ligjeve dhe modeleve në Shqipëri që i miratojmë në momentet e fundit ose fshehurazi pa diskutimet e grupeve të interesit dhe në momentin që miratohen fillojnë dhe diskutohen, por askush nuk i zbaton, kjo është një praktikë që ne e kemi ndeshur shpesh në Shqipëri.

Dua që ky diskutim të fillojë që tani, të hapet diskutimi me të gjitha grupet e interesit, partitë politike, me të gjitha fushat dhe të dalë një vendim, model sistemi që të zgjidhë njëherë e mirë dhe në mënyrë përfundimtare në Shqipëri dhe në momentin që miratohet, ai vetëm të zbatohet.

Pra, përfundimisht unë dua të vendoset në planin e punës dhe të fillojë diskutimi.

Damian Gjikhuri - Zoti Lita, për t'ju sqaruar, sepse më vjen keq që i kthehem të njëjtës pikë. Çështja e sistemit zgjedhor jo vetëm është në rendin e ditës, por është objekt kryesor i punës së Komisionit për Reformën Zgjedhore. Çështja e sistemit zgjedhor është vënë si afat e fundit, por kjo nuk do të thotë se puna nuk vazhdon paralel. Të gjitha afatet këtu janë për produktin final. Arsyeja pse kërkohet më shumë kohë për sistemin zgjedhor, është pasi mund të ndryshojmë edhe Kushtetutën e Shqipërisë. Kjo është një çështje që kërkon kohë dhe ekspertizë. Meqenëse ky komision duhet të ecë paralel me disa çështje dhe...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ju lutem, ta mbaroj!

Ta dëgjojnë të gjithë dhe të mos e vazhdojmë këtë debat, sepse nuk ia vlen, meqenëse ky komision ka disa çështje parësore, përfshirë edhe çështjet e sistemit zgjedhor, por njëra është më afër dhe e gatshme për t'u miratuar dhe pjesa tjetër do të dojë më tepër kohë, e kemi bërë këtë ndarje me afate kohore, që do të thotë se e gjithë puna fillon paralel.

Pak më parë bisedova edhe me ambasadorin e OSBE-së në lidhje me atë se sa më shpejt ata mund të sjellin një ekspert ndërkombëtar. Natyrshëm gjithçka do të zhvillohet me tryeza të hapura. Të mos harrojmë se sistemi zgjedhor mund të prekë edhe Kushtetutën e Shqipërisë. Ka edhe opsione që brenda këtij sistemi mund të ketë edhe axhustime, por kjo mbetet pjesë e konsensusit politik që do të arrijmë. Pra, përderisa do të ndryshojmë Kushtetutën ka tryeza, ka ekspertizë, ka debate të gjera dhe në fund do një konsensus maksimal, sepse njëra palë mund të mos jetë dakord, mund ta çojë atë gjë edhe në referendum. Pra, kjo është një çështje serioze, sepse sistemi është ndryshuar disa herë në Shqipëri. Në vitin 2008 për herë të fundit është ndryshuar Kushtetuta. Edhe më parë ka qenë sistem tjetër. Ka qenë miks, por ka ndryshuar.

Ju lutem, edhe për kursimin e kohës!

Korab Lita - Kam edhe diçka të vogël dhe nuk flas më.

Damian Gjikhuri - I the të gjitha.

Korab Lita - Po ma deformon atë që thashë. Problemi është i tillë: pikërisht pse është aq e rëndësishme sa thoni ju, duhet të fillojë dhe të vihet tani në rendin e ditës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, nuk e keni në rendin e ditës.

Zoti Gjikhuri, duhet ta kuptoni se pjesa tjetër e grupit nuk është ajo që keni pasur, por është një pjesë tjetër, kemi hyrë në diçka shumë objektive. Unë dua të vendoset që tani në planin e punës.

Damian Gjikhuri - Është pika e katërt e rendit të ditës, është thjesht afati, pasi kërkon më shumë kohë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ralf Gjoni- Zoti Gjikhuri, zonja Hjadari se jeni bashkëkryetarë.

E para punës, ju po silleni si një kryetar dhe jo si bashkëkryetar. Më duhet ta sqaroj këtë punë.

E dyta, mos na kujtoni sesa herë duhet të flasim. Do të flasim sa herë të kemi nevojë në këtë komision, sepse kemi ardhur këtu pikërisht që të diskutojmë. Ne nuk po bëjmë politikë, ne po flasim për diçka reale.

Unë kam një pyetje: para se të shkojmë te votimi, me lejen edhe të zonjës Hajdari, sepse kemi edhe një bashkëkryetare, nuk jeni vetëm ju. Ju lutem, meqenëse kemi edhe përfaqësuesit e nderuar të OSBE-së këtu në këtë tryezë, kush i ka vendosur këto afate? Neve na është dhënë thjesht një copë letër me disa afate, rekomandimet e OSBE/ODIHR-it deri më 30 qershor të 2019-ës.

Të nderuar përfaqësues të OSBE/ODIHR-it në dijeninë time drafti, siç e tha zoti Musaj nuk i adreson të gjitha rekomandimet e OSBE/ODIHR-it, madje është shumë larg. Si mund të jetë e mundur që ne të miratojmë një draft të plotë me rekomandimet e plota të OSBE/ODIHR-it brenda 30 qershorit të 2019-ës?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Një pyetje bëra, nuk është ndonjë problem. Pse e ktheni në politikë menjëherë! Unë po bëj një pyetje teknike: kush i ka vendosur dhe mbi çfarë baze kriteresh janë vendosur këto afate kohore? Përse rekomandimet e OSBE/ODIHR-it janë deri më 30 qershor të 2019-ës? Pse ju e merrni të mirëqenë se paskeni bërë një draft që e keni marrë me dëshirën tuaj, pa dakordësinë e opozitës së kaluar dhe mendoni se ne kemi ardhur këtu si noterë, që thjesht do të votojmë draftet tuaja.

Zoti Gjyknuri, nuk ka asnjë shans!

Ju lutem, dua të na shpjegoni se kush i ka caktuar këto afate dhe mbi çfarë baze kriteresh janë caktuara ato?

Damian Gjyknuri - Përpara se të kalojmë te pika për të diskutuar dhe për të miratuar këtë, të mbarojmë, të ezaurojmë raundin e diskutimeve për të gjithë anëtarët.

Fjalën e ka zonja Gjylameti. Pastaj do t'ju jap përgjigje.

Ju lutem, të mos marrim fjalën nga dy herë, sepse do të kemi kohë! Të mos përfitojmë nga fakti se kemi kamerat këtu dhe o burra, të shpalosim të gjithë idetë tona!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Do t'i heqim në mbledhjet e tjera. Tani është mbledhja e parë.

Blerina Gjylameti- Faleminderit!

Falënderoj të gjithë kolegët e opozitës për padurimin që kanë për të vazhduar punën me një nga çështjet që na shqetëson të gjithëve, por besoj se standardet e zgjedhjeve dhe problematikat që kanë të bëjnë me procesin zgjedhor, nuk fillojnë e mbarojnë me ndryshimin e sistemit zgjedhor. Sepse, nëse do të ishte kështu, nuk do të kishte ndryshuar sistemi

zgjedhor para dhjetë vjetëve, por do të kishim ngelur me sistemin që kishim. Më pak mund të arrijmë sot në këtë tryezë, që çdo diskutim ta kthejmë në perceptime, apo çdo diskutim ta fokusojmë vetëm te sistemi zgjedhor.

Jam i bindur se me ndryshimin e objektit të këtij komisioni do të kemi kohën e duhur, sepse për çështjet e sistemit zgjedhor duhet shumë kohë, që të organizojmë tryeza diskutimesh edhe me ekspertë të huaj, në mënyrë që zgjidhjen që do t'u japim në fund problematikave, të cilat do t'i ngremë të gjitha, të arrijmë t'i adresojmë me një punë konkrete dhe me një draft ligji të tillë që, kur të shkojë në Kuvend, të jetë i gjithëpranuar nga ne, por mbi të gjitha të realizojë atë që është objektivi i këtij komisioni: perceptimi apo rritja e besimit të qytetarëve te vota e lirë, si dhe arritja e standardeve që duhet të kemi në zgjedhje të lira, demokratike e të gjithëpranuara.

Unë besoj se pjesa e retorikës politike apo edhe çështjet që ne po ngremë sot këtu, nuk janë të vetmet. Kështu, në lidhje me çfarë kemi pasur shqetësim ndër vite, por gjithashtu edhe nga institucionet që tashmë prej vitesh monitorojnë proceset zgjedhore në Shqipëri, janë edhe në rekomandimet e raporteve që dalin pas zgjedhjeve, që adresohen nëpërmjet punës konkrete.

Tashmë, brenda një viti e gjysmë është bërë një punë, por që absolutisht që mund të ketë nevojë për përmirësime. Kemi një draft paraprak, që është një pikënisje shumë e mirë, sepse realisht, një pjesë nuk ka qenë, një pjesë kemi qenë në atë komision, ku është bërë një punë shumë e mirë me të gjitha palët, që ishin pjesë të komisionit, si dhe me ekspertë të huaj, në tryeza e tavolina, për të adresuar problematikat kryesore që kanë ngritur të gjitha partitë politike në Shqipëri, por po ashtu edhe institucionet që kanë monitoruar problematika që lidhen qoftë me shitblerjen e votës, qoftë me atë që është një problem shumë i madh, i cili lidhet me çështjen e transparencës në financimin e partive politike. Po ashtu, ka edhe problematika të tjera, të cilat kanë të bëjnë me çështjen e votimit të emigrantëve, si dhe me çështjen e depolitizimit.

Kështu, le t'i kthehemi asaj që ka të bëjë me axhendën që adreson të gjitha problematikat e ngritura, e gjithashtu edhe me çështjen e ndryshimit, apo çështje që kanë të bëjnë me sistemin zgjedhor, e le ta fillojmë punën tonë. Kur më pas të kemi debate mbi teknikalitete apo çështje që do të duhet t'i diskutojmë, që më pas të marrim vendime, le t'u kushtojmë kohën e nevojshme. Të mos nisim duke e paragjykuar njëri-tjetrin që sot, e më pas, si zakonisht, ta kthejmë në një punë që nuk merr fund, por vazhdojmë të harxhojmë kohë, pa gjetur zgjidhje, sa i takon një problemi që nuk është i pakët në Shqipëri. Vullnetin politik e kemi treguar që prej një viti e gjysmë tashmë, që duam të gjithë së bashku t'i japim

zgjidhje, me qëllim që në fund fare, ata të cilët na kanë votuar, qoftë me listë të mbyllur, qoftë me maxhoritar, të marrin atë çfarë presin prej atyre që kanë votuar.

Faleminderit!

Damian Gjikhuri – Faleminderit!

Tashti, për të qenë racionalë, zoti Murrizi, do të kemi kohë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të lutem! U mbyll diskutimi.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kam reminishenca diktatori, por diktatura vlen ndonjëherë për të mbajtur axhendën e punës.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Dëgjo tani, të lutem!

Shumë mbledhje të tjera mund t'i bëjmë pa kamera, me dakordësinë tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Myslym Murrizi – Fiki kamerat! Desha të them diçka.

Damian Gjikhuri – O Myslym, a do t'i rrimë rendit të ditës? Mos ta bastardojmë fare.

Myslym Murrizi – Ju, o zotëri, e keni ndryshuar këtë sistem për 12 minuta, me telefon.

Për të bërë një gjë të mirë, që qytetarët të zgjedhin të zgjedhurin e tyre, u dashka shumë mund e sakrificë, djersë. Unë e di se e mira kërkon mund. Atje në Myzeqe, ku jam unë, fasulja do punë, ndërsa grami rritet vetë. Me telefon e ka ndryshuar Bashkim Fino Kushtetutën në prill të 2008-ës, se ti nuk ke qenë në Kuvend.

Damian Gjikhuri – Dëgjo, dëgjo tashti...

Myslym Murrizi – Tashti do të them dy gjëra për sistemin. Një minutë, një minutë. Miku im Fino, kur ka qenë sistem maxhoritar, ka ardhur në Kuvend në '97-ën si deputet i Kuçovës. Në 2001-shin si deputet i Kuçovës, në 2005-ën si deputet i Kuçovës. Sa ndryshoi sistemi, në 2009-ën, erdhi në Fier, në 2013-ën ia kërciti në Korçë, ndërsa në 2017-ën njëqind e pesa u kthye prapë në bazë, prapë në Fier.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Sepse bredhin pra deputetët, nga ky lloj ligji, dhe s'ndejnë asnjë lloj peshe. Në botëkuptimin tim...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Fino ka të drejtë, se është anëtar i Partisë Socialiste. Ky e koncepton partinë repart ushtarak. Unë e dua partinë demokratike.

Damian Gjijnuri – Të lutem tashti, i the këto gjëra. Jam dakord...

Myslym Murrizi – Jo, jo, se do të tregoj. Në '96-ën, të kanë dalë të pavarur Lad Fejzo e Maks Hasani, në '97-ën Maks Hasani, në 2001-shin Spiro Peçi, të ka dalë Bahri Boriçi i pavarur, Nard Ndoka i pavarur dhe një tufë kryetarësh komune. Ju bëni sikur duhet të pushkatohet ai që del i pavarur! Pse e keni kaq siklet votën e qytetarëve?

Damian Gjijnuri – Të jap përgjigje për këtë, se e the.

Jemi mbledhur jo për të diskutuar sistemin. Myslym, mbylle një çikë mikrofonin tashti. Për respekt, që të mbajmë një rend pune.

Ti ke opinionet e tua për sistemin. Shumë mirë. E pëlqen maxhoritarin, je këtu në këtë tryezë, për të propozuar sistemin që ti pëlqen.

Ju lutem shumë, që të mirëkuptohemi: nuk e zgjidhim çështjen sot çështjen e sistemit, që të na dëgjojë publiku, u ngritën edhe disa pyetje. Tashti, ky komision duhet të avancojë, gjë që do të thotë se ne do të realizojmë një sërë objektivash që i kemi vënë vetes. Kemi përpara një axhendë pune. Pse u vunë çështjet e rekomandimeve të OSBE/ODIHR-it, e thashë në fillim, që ta ezaurojmë këtë bisedë. U tha 30 qershori, jo se ne e kemi gjithçka gati, po pikërisht për t'u dhënë kohë të gjithë anëtarëve të rinj, në mënyrë që të reflektojnë në lidhje me gjithë atë punë të bërë, gjashtëmujore a shtatëmujore, edhe me ekspertizë profesionale.

Megjithatë, prandaj thamë se do të emërojmë ekspertët dhe do të bëjmë axhendën tonë të punës, të detajuar, mbase edhe përtej kamerave, në mënyrë që të thoni: jeni dakord me këto propozime? S'jeni. Keni mendim ndryshe?

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Patjetër! Nuk do të jetë paketë e gatshme. Po ta shikoni, komisioni nuk ka ndryshuar asgjë nga pikëpamja e rregullave. Kanë ndryshuar anëtarët, por rregullat janë të njëjtat, gjë që do të thotë se produkti këtu del konsensual. Ju keni të drejtën të thoni: ne nuk na pëlqen kjo!

Për çështjet në lidhje me të cilat nuk biem dakord, është e shkruar në vendimin e komisionit për rekomandimet e ODIHR-it, ne mund t'i drejtohem ekspertizës së huaj, pra ekspertizës së ODIHR-it, në mënyrë që të saktësojë nëse këto janë brenda standardeve apo jo.

Pjesës tjetër, e cila është diskrecionale politike, emigrantët, teknologjia, sistemi zgjedhor, i kemi lënë më shumë kohë, sepse ka debate. Ka Myslym, por ka edhe Myslymë të tjerë, të cilët mund ta duan sistemin në lloje të tjera, e shikojnë politikën ndryshe. Ne nuk jemi këtu për ta zgjidhur këtë punë tashti. Ne jemi që të krijojmë mundësinë e punës, ndaj ju

lutem shumë, ejani ta miratojmë këtë axhendë, të miratojmë edhe ekspertët, të fillojmë punën, me qëllim që të ecim përpara. Do të kemi kohë të debatojmë në lidhje me çështjen e sistemit.

Në qoftë se nuk ka ndonjë gjë tjetër, bashkëkryetare, në lidhje me këtë axhendë, le ta hedhim në votim, që të vazhdojmë përpara.

Rudina Hajdari – Lidhur me planin e punës, me mirëkuptimin tuaj, por edhe të të pranishmëve këtu, anëtarëve të tjerë të komisionit, mendoj se shqetësimi kryesor i anëtarëve të opozitës është fakti se këtu ka disa afate kohore, me të cilat nuk biem dakord, sepse nuk është diskutuar në grupin e opozitës. Kështu, me dakordësinë tuaj, mendoj se këto afate kohore mund të diskutohen edhe një herë. Plani le të mbetet i njëjtë. Pra, t’i diskutojmë këto tema siç janë aty, po për sa u përket planeve, afateve kohore, le t’i ridiskutojmë me grupet tona parlamentare, e pastaj të shohim. Ndoshta do të ishte mirë që ne të bënim një plan në lidhje me kohën se kur do të jetë takimi ynë i ardhshëm, në mënyrë që të ecim me këto tema.

Gjithashtu, nëse kam edhe dakordësinë tuaj si bashkëkryetar, do të ftoja paraprakisht për organizimin e një tryeze në lidhje me diskutimin e çështjes së sistemit zgjedhor, e jo vetëm me anëtarët e trupit diplomatik, sepse nuk besoj se ata janë shumë të interesuar për sa i përket kësaj teme, por me shoqërinë civile, e cila do të ishte më reflektuese sa i takon mendimit të njerëzve, pra shqiptarëve në përgjithësi, se ku janë ata në lidhje me këtë çështje.

Mendoj se kjo çështje duhet të zgjidhet apo të diskutohet vetëm nëse i intereson vendit, Shqipërisë. Pra, nëse mund të kemi një lloj tryeze, së bashku me shoqërinë civile, bashkë me komisionet e tjera që kanë dëshirë të marrin pjesë në këtë diskutim, kjo do të ishte një pikënisje e mbarë, që do të ezauronte disa nga këto shqetësime.

Ralf Gjoni – Zonja Hajdari, a mund të bëj një propozim konkret, ju lutem?

Rudina Hajdari – Për sa i përket planit tjetër, besoj se biem dakord.

Ralf Gjoni – Një propozim, vetëm si shtojcë ndaj

Damian Gjijnuri – Ta diskutoni me veten tuaj, apo jo, se unë jam dakord...

Ralf Gjoni – Me mirëkuptimin tuaj, zoti Gjijnuri dhe zonja Hajdari, me mirëkuptimin edhe të anëtarëve të Partisë Socialiste në këtë komision.

Në mënyrë që të ketë mjaftueshëm kohë për të adresuar të gjitha rekomandimet e OSBE-ODHIR-it, para se të votojmë, a mund të propozoj të shtyhet afati, nga data 30 qershor në 31 shtator 2019? Besoj se nuk do të ketë ndonjë problem nga ju.

Damian Gjijnuri - Unë e shikoj si problem. Është një punë e bërë. Janë harxhuar para. Është harxhuar energji njerëzore. Gjërat janë gati. Megjithatë, ne nuk i konsiderojmë gjërat gati pa marrë miratimin e kësaj tavoline.

Përse duhet kjo kohë? Pse është 30 qershori? Sepse ka eksperiencë edhe më parë reforma zgjedhore dhe nuk filloi me ardhjen tuaj apo me ardhjen tonë këtu.

Të lutem!

Ka eksperiencë nga pikëpamja procedurale, sepse Këshillit të Europës dhe ODHIR-it u duhet disa muaj të japin ekspertizën e tyre për këtë. Siç e tha edhe ambasadori, duhet edhe një vit kohë të implementohet legjislacioni i ri. Ne nuk mund të rrezikojmë në shtator, që opinioni të vijë pranverën e vitit tjetër dhe pastaj reforma të mbetet peng e debateve politike.

Ralf Gjoni – Pse, keni planifikuar zgjedhje në shtator 2020, që paska problem muaji shtator 2019?! Nuk e kuptoj!

Damian Gjiknuri – Të lutem!

Ne duam që këtë reformë... Jemi shumë të vonuar...

Ralf Gjoni – Ambasadori, që është edhe prezent, mund të na thotë nëse rekomandimet e OSBE-ODHIR-it janë adresuar. Nuk është normale!

Ne po bëjmë një propozim konkret, zoti Fino, për shtyrjen e afatit.

Damian Gjiknuri – Zoti Gjoni...

Ralf Gjoni – Mos e merrni të mirëqenë draftin tuaj dhe ne si noterë...

Damian Gjiknuri - Zoti Ralf, të lutem!

Unë ju dhashë kohë. Ju thatë se nuk jeni dakord me këto afate. Ju doni të bëni diskutimin tuaj, por duhet ta keni parasysh këtë fakt, sepse këtu jemi edhe për interesin publik. Kjo nuk është tavolinë për të zgjidhur hallet tona. Interesi publik është që, brenda një afati të arsyeshëm, për t'u dhënë kohë edhe institucioneve ndërkombëtare, si ODHIR-i, të shprehen për këtë produkt, sepse nuk e certifikojmë ne këtë. Ne mund të bëjmë edhe shkencën tonë këtu dhe të biem dakord për disa rregulla, por dikush do të thotë se këto janë jashtë standardit dhe nuk i adresojnë të gjitha rekomandimet. Për t'i dhënë kohë kësaj, vura një afat të arsyeshëm.

Zonja Hajdari kërkoi ta diskutojmë edhe një herë. Jam dakord. Unë them ta diskutojmë edhe një herë, ne, si bashkëkryetarë dhe ju, si anëtarë.

Shumë shpejt, në mbledhjen e ardhshme, të cilën ne e vendosim me një njoftim 24-orësh, t'i miratojmë këto afate dhe të fillojmë. Këto afate nuk janë kushtetuese, por janë të punës. Këto janë kufij, që na mbajnë në presion për të realizuar produktin tonë.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Pikat janë ezauruar dhe i kemi të gjitha çështjet të adresuara.

Mund të adresojmë edhe një problem tjetër, në qoftë se biem dakord.

Kemi 4 ekspertë për t'i emëruar. Kemi rënë dakord me bashkëkryetaren të mbajmë ekspertët e mëparshëm, zotin Rusmali dhe zotin Gumi, meqenëse kanë qenë pjesë e kësaj reforme dhe kanë ekspertizën e duhur. Në fund të fundit, kjo është një punë në vazhdimësi. Kemi rënë dakord t'i marrë si ekspertë teknikë.

Ndërkohë, ne, si palë, si bashkëkryetarë, do të propozojmë një anëtar tjetër ekspert.

Ne, si maxhorancë, kemi propozuar një ekspert jurist, Dritan Cakën. Zonja Hajdari, si bashkëkryetare, ka propozuar një emër tjetër, sepse kështu ka qenë rregulli i këtij Kuvendi, për një ekspert tjetër. Këtë emër ju mund ta thoni tani dhe ne do ta quajmë të ezauruar.

Ndërkohë, kam edhe një propozim të fundit për administratën Kuvendit, që do të na duhet për suport.

Vazhdoni, zonja Hajdari.

Rudina Hajdari - Duke dashur ta mbyllim këtë takim, eksperti tjetër i grupit demokrat është i huaj dhe vjen nga Britania e Madhe. Ai ka punuar për OSBE-ODHIR-in në Ukrainë dhe në disa vende të tjera. Kështu që e njeh mirë sistemin dhe zgjedhjet parlamentare. Ai ka ndjekur dhe observuar shumë zgjedhje dhe është kënaqësi që është i pranishëm këtu.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Emri është Hygo Strajt, është ulur atje sipër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Damian Gjikhuri – Të lutem, zoti Murrizi!

Pika e fundit e rendit të ditës.

Do t'i kërkojmë OSBE-ODHIR-it të na mbështesë me ekspertizë, me financim për çështjet e sistemit, njëkohësisht, edhe administratës së Kuvendit për të na mbështetur me fonde të vlefshme, për të paguar ekspertizën që do të na vihet në dispozicion. Besoj se të gjithë jemi dakord me këtë vendimmarrje, që t'u drejtohem këtyre dy institucioneve, pra administratës së Kuvendit dhe OSBE-ODHIR-it.

Me mirëkuptimin e bashkëkryetares, dua t'ju falënderoj!

Vërtet ishte një takim me pak debat, por ishte takimi i parë. Një pjesë juaja mbase nuk e ka pasur eksperiencën në reformën zgjedhore, por e mirëpritët takimin e parë për të shpalosur pikëpamjet tuaja. Kjo është krejt normale.

Çështjet e sistemit dhe çdo gjë tjetër në këtë komision, do të trajtohen, por, mbi të gjitha, duhet të mbajmë klimën e komunikim.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Jo, i votuan. Kërkuan kohë vetëm për afatet. Pra, si tema ramë dakord. Ramë dakord që do t'i drejtohem edhe OSBE-së për mbështetje. E vetmja gjë që mbetet për t'u diskutuar është çështja e afateve, që do të biem dakord pasi...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

E thamë. U votua dhe u miratua. Vetëm afatet u lanë për një bisedë tjetër.

Jeni dakord?

Dakord, u miratua.

Për takimin tjetër do të vendosim bashkë dhe do t'ju njoftojmë 24 orë para.

Rudina Hajdari –Besoj se takimi tjetër do të jetë brenda këtij muaji.

Damian Gjiknuri – Patjetër.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Nuk kemi lënë fjalë për përfaqësues nga shoqëria civile, sepse ky është Komisioni i Reformës Zgjedhore.

Siç e tha edhe zonja Hajdari dhe për të qenë transparent me publikun, shumë shpejt, për të gjitha propozimet që do të diskutohen në këtë komision, do të organizojmë edhe tavolina të rrumbullakëta me të gjithë përfaqësuesit. Pra, çdo draft që do të vijë në këtë tavolinë dhe do të diskutohet në Komisionin e Reformës, natyrshëm, do të marrë edhe opinionin e shoqërisë civile dhe të personave të interesuar për zgjedhjet. Këto janë format e punës. Ky është komision parlamentar. Bëjmë ndonjë përjashtim për disa përfaqësues të nderuar, sepse kanë qenë pjesë e kësaj reforme, kanë dhënë para, mbështetje dhe, në fund të fundit, i duam në krah për të arritur standardet më të mira të zgjedhjeve.

Kështu që, me mirëkuptimin tuaj, ju falënderoj për kontributin në këtë mbledhje!

Mbledhjen e konsideroj të mbyllur, pavarësisht debateve deri diku...

MBYLLET MBLEDHJA